



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 23

Prishtinë, më 16.04.2018, në orën 14:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Hajdar Beqa, Sami Kurteshi, Shkumbin Demaliaj, Nezir Çoçaj, Arben Gashi, Bilall Sherifi, dhe Igor Simiç.

Munguan: Bahrim Shabani, Glauk Konjufca, dhe Korab Sejdiu.

Mbledhjen e kryesoi, Kryetarja e Komisionit Albulena Haxhiu.

Rendi i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Përfundimi i Kryesisë së Kuvendit nr. 06-P-039 lidhur me kryesimin e Komisionit Parlamentar Hetimor;
3. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Përfundimi i Kryesisë së Kuvendit nr. 06-P-039 lidhur me kryesimin e Komisionit Parlamentar Hetimor;

Kryetarja-njoftoi anëtarët e komisionit për pikën e rendit të ditës ku tha se Komisioni për Legjislacion është ngarkuar për të dhënë sqarime lidhur me atë se kush ka të drejtë të kryesojë Komisionin Parlamentar Hetimor në lidhje me ndriqimin e rastit të dëbimit të gjashtë shtetasve turq nga Kosova. Ajo me tej i'u referua nenit 10 të Ligjit për Hetimin Parlamentar i cili thotë si vijon: “Kryesuesi i Komisionit emërohet nga Kuvendi me rastin e themelimit të komisionit,

kryesuesi zgjidhet nga radhët e njërit grup parlamentar i cili nuk është iniciator”. Pra deputēja Haxhiu tha se në kryesim të Komisionit Hetimor përjashtohet vetëm grupi inicues, në këtë rast LDK-ja.

Arben Gashi-tha se nuk ka pasur një kërkesë formale për Komision Hetimor Parlamentar me procedurë të zakonshme, por ky komision ka ardhur si konkluzion i një seance, nëse shikohet në mënyrë kronologjike, i bie që kërkesa është bërë nga LDK-ja dhe LDK-ja është propozues i Komisionit për Hetim Parlamentar, për këtë arsye nuk i takon LDK-së që ta udhëheq këtë komision theksoi deputeti Arben Gashi.

Hajdar Beqa-tha se udhëheqja e këtij komisioni nuk i takon inicuesit por as partive të cilat janë në pushtet. Deputeti Hajdar Beqa tha se kërkesa nuk ka përmbajtje dhe si e tillë ai propozoi që me këtë çështjet të mirret Kryesia e jo Komisioni për Legjislacion, ai shtoi duke thënë se nuk mund të votojë diçka që bie ndesh me ligjin.

Bilall Sherifi-tha se sa i përket kësaj çështje të gjithë kemi rënë dakord por që është inicuar vetëm nga LDK-ja. Ai tha se kjo kërkesë në komision duhet të interpretohet në këtë mënyrë, pastaj kushdo që mendon se ky vendim ose interpretim është i gabuar, ekzistojnë rrugët ligjore të kontestimit të një vendimi të komisionit theksoi deputeti Bilall Sherifi.

Sami Kurteshi-tha se të gjithë jemi pajtuar për këtë, ndërsa a do të ketë rezerva ligjore në atë se a mund ta kontestoj dikush është çështje tjetër, në këtë rast komisioni do ta nxjerr një raport i cili nuk është ligj ka të bëjë vetëm me krijimin e një Komisioni Hetimor.

Pas diskutimeve, kryesuesja konstatoi se me gjashtë vota “për” “një” kundër dhe “një” apstenim komisioni vendosi që Kuvendit t’ia paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

Komisioni, duke vepruar në pajtim me përfundimin e Kryesisë së Kuvendit nr. 06-P-039, si dhe duke vepruar në pajtim me Ligjin nr. 03/L-176 për Hetim Parlamentar, vlerësoi se inicues i debatit parlamentar, në lidhje me rastin e deportimit të 6 (gjashtë) shtetasve të Republikës së Turqisë, është Lidhja Demokratike e Kosovës dhe mbi këtë bazë Kuvendi ka formuar Komisionin Hetimor, kryesimi i të cilit nuk mund të bëhet nga Lidhja Demokratike e Kosovës.

3 Të ndryshme .

Në këtë pikë të rendit të ditës nuk kishte diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 14:18

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Albulena Haxhiu